



Pranimi / Dorezimi Punëtor/Prodator Receiver/Deliverer	10-01-9	viti and year	
Organ /Njesia Organ /Zjednica Org /Unit	H/ Prot H/ Prot Prot No	Shtoja Protig Appendix	Sasia Kufizimi Quantity
SKMSTICK	183/2024		1/9



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1403/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti, anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1403/2023, të datës 10.11.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike-administrative “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të dispozitave të Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.01.2024, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Apropohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1403/2023, e datës 10.11.2023, e parashtruar nga ankuesi

II. Detyrohet Komisioni i Vlerësimit për Ngritje që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative ashtu që procedura për ngritje (avancim) në detyrë, me numër reference RN00012045, për pozitën e punës *Udhëheqësi i Sektorit për Sigurinë e Produkteve*, të vazhdoj me fazën e vlerësimit të intervistës me gojë.

IV. Obligohet Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën II të dispozitivit.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi (me tej referuar ankuesi), më datë 10.11.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e regjistruar nën shenjë A.nr.1403/2023, kundër Vendimit Ref.02/Nr.381, të datës 08.11.2023, të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së

Industriisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me pretendimet ankimore se Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm me rastin e anulimit të procedurës për pozitën *Udhëheqës i Sektorit për Sigurinë e Produkteve*, ka ndërhyrë në një procedurë të rregullt rekrutimi dhe së i njëjti me vetëdije të plotë ka abuzuar më detyrën e tij zyrtare dhe ka bërë shkelje të procedurave administrative. Thekson së vendimi i kundërshtuar është bazuar në tejkallim të afateve, vonesa këto të qëllimshme e të shkaktuara nga vet Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm, në bashkëpunim më komisionin e pranimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej vetëm Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën për Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 17.11.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industriisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa, kjo e fundit, me datë 21.11.2023, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me provat materiale lidhur me këtë çështje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:6961/2023 të datës 10.11.2023, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Ref.02/Nr.381 të datës 08.11.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm në MINT; Komunikimet elektronike të datës 08.11.2023, 06.11.2023, 02.11.2023 ndërmjet zyrtareve të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MINT dhe ankuesit; Njoftimin përmes e-mailit zyrtar të datës 06.11.2023 nga ankuesi për Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm në MINT; Komunikimin elektronik të datës 07.11.2023, 06.11.2023, 01.11.2023, 15.09.2023, 16.08.2023 ndërmjet ankuesit, Zyrtareve të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MINT dhe SIMBNJ-së; Kopjen e konkursit me numër të referencës RN00012045 të datës 17.07.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 17.11.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë të datës 21.11.2023 nga Ministria e Industriisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë së bashku me shkresat e bashkangjitura; Vendimin me numër Ref.02/Nr.275 të datës 31.08.2023 lidhur me formimin e komisionit të vlerësimit-KVND-së; Listën e aplikantëve të gjeneruar në SIMBNJ; Njoftimin e datës 16.08.2023 lidhur me listën e ngushtë nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Njoftimet elektronike të datës 02.11.2023, 06.11.2023 lidhur me shterjen dhe mbajtjen e intervistës me gojë nga Njësia e Burimeve Njerëzore dhe anëtarët e komisionit konkrete, Vendimin me numër protokoll 7556/2023 të datës 19.12.2023 lidhur me vazhdimin e afatit për vendosje të ankesës dhe Vendimin A.nr.1423/2023 të datës 19.12.2023 të KPMSHCK-së.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi analizimit dhe shqyrtimit të provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është **e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Industriisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me datë 11.07.2023 (*afati për aplikim 04.08.2023 – 11.08.2023*) ka publikuar Konkursin për Ngritje (avancim) në Detyrë, me numër reference N00012045, për pozitën e punës *Udhëheqësi i Sektorit për Sigurinë e Produkteve*, në Departamentin e Inspektoratit të Tregut, klasa Drejtues i Ulët, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, duke u përfshirë në listën e ngushtë të datës 16.08.2023, dhe së i njëjti i është nënshtruar testit me shkrim si dhe vlerësimit të CV-së.

Tutje nga provat e lëndës rrjedhe se ankuesi me datë 02.11.2023 është njoftuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore lidhur me datën dhe kohën e intervistës me gojë, e cila ishte planifikuar të mbahej më datë 06.11.2023 duke filluar nga ora 14:00, ndërsa, po në datën ku duhet të mbahej intervista me gojë pra më datë 06.11.2023, ankuesi njoftohet se shtyhet intervista me gojë për datën 08.11.2023 në ora 14:45. Sërisht me datë 08.11.2023, ankuesi njoftohet me shkrim nga Njësia e Burimeve Njerëzore lidhur me anulimin e intervistës bazuar në Vendimin me numër Ref.02/Nr.381 të datës 08.11.2023, të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industriisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Kolegji i Këshillit duke vepruar sipas autorizimeve kushtetues dhe ligjore për mbikëqyrjen e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e në mbështetje të nenit 86 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka shqyrtuar në kuptim të vlerësimit të ligjshmërisë veprimet procedurale të ndërmarra në këtë procedurë të ngritjes (avancim) në detyrë, dhe si rrjedhojë ka gjetur se afati për aplikim për këtë procedurë ka qenë nga data 04.08.2023 deri më datë 11.08.2023, ndërsa, lista e ngushtë, gjegjësisht lista e kandidatëve që kanë plotësuar kushtet për të vazhduar me fazat e mëtejme është bërë me datë 16.08.2023, pra, lista e ngushtë është nxjerrë nga Njësia e Burimeve Njerëzore të MINT-it brenda aftave ligjore të përcaktuara me nenin 45 paragrafin 4 ndërlidhur me nenin 57 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës. Ndërsa, Komisionit për vlerësim është themeluar me datë 31.08.2023 me Vendimin ref.02/nr.275, të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MINT-it, kurse testi me shkrim është mbajtur me datë 15.09.2023, më ç ‘rast ankuesi kishte arritur gjithsej 47 pikë të vlerësimit, dhe vlerësimi i CV-së është bërë më datë 01.11.2023, ku ankuesi ishte vlerësuar me gjithsej 8 pikë. Pra, mbi bazën e këtyre fakteve rrjedhë se veprimet procedurale në fazën e vlerësimit kanë qenë të tej zgjata dhe se organi i punësimit në përgjigje në ankesë me asnjë prove nuk ka rritur të argumentoj pse kanë ndodhur këto vonesa procedurale dhe se me asnjë provë nuk vërtetohet se kandidatet janë njoftuar me arsyet e këtyre vonesave apo me shtyrje të afateve siç është paraparë me nenin 99 të Ligjit Nr. 05/L-051 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrejdhimisht në vlerësimin e Kolegjit këto veprime të organeve gjegjësen në fazën e vlerësimit janë në kundërshtim me frymën e dispozitave të nenit 9 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-051 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: **“1. Organet publike duhet të veprojnë me transparencë. 2. Organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t’u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë Ligj”.**

Duke qenë se ankuesi më ankesën A.nr.1403/2023 ka atakuar vendimin Ref.02/Nr.381, të datës 08.11.2023, të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, mbi bazën e të cilit vendim është anuluar konkursi më numër reference N00012045, për pozitën e punës *Udhëheqësi i Sektorit për Sigurinë e Produkteve*, Kolegji nuk trajtoj ligjshmërinë e këtij akti, për faktin që Këshilli me Vendimin A.nr.1423/2023 të datës 19.12.2023 ka shfuqizuar të njëjtin, pas konstatimit se vendimi i atakuar është në kundërshtim me nenin 47 dhe nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-051 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 99 paragrafin 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë, dhe si rezultat i këtyre shkeljeve ky akt është shpall i pavlefshëm në kuptim të nenit 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-051 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrejdhimisht Kolegji nisur ky konstatim e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vlerësoj se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, ndaj vendosi për aprovimin e ankesës, duke obliguar Komisionin e Vlerësimit për Ngritje në Detyrë që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative ashtu që procedura për ngritje (avancim) në detyrë, me numër reference RN00012045, për pozitën e punës *Udhëheqësi i Sektorit për Sigurinë e Produkteve*, të vazhdoj me fazën e vlerësimit të intervistës me gojë.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1403/2023

Ardita Perçuku-Shyti


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

